



Npi – 01/460 datë: 27.12.2023

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (c), nenin 17 shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Neni 65 paragrafi 2 i Ligjit për Sport Nr.2003/24; Neni 14 i Ligji Nr.04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/24 për Sport; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe procesit të mbajtur të diskutimit publik me qytetarë, në seancën e rregullt të mbajtur më datën 27.12.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË SPORT

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX- për vitin 2023, të mbajtur më: 27.12.2023, me shumicën e votave miratoi Rregulloren Komunale për procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e Laureatëve të vitit në sport, duke integruar në rregullore edhe 3 propozimet e dala nga diskutimi publik si vijon:

1. Te Aneksi 2 - Tabela e poentimit, të plotësohet pika e fundit si vijon: Ekipi me struktura të kompletuara dhe ekipi më i organizuar me të gjitha kategorit e grupmoshave.
2. Te Neni 3, pika 3.2 të shpërblimet të shtohet: Edhe Shpërblimi i Sportistëve të cilët kanë përfaqësuar Kosovën në arenën ndërkombëtare (kampionat Evropian, Ballkanik, Kupa Evropiane dhe Kupa Botërore) këta sportist mos të jenë në garë për sportist të vitit.
3. Te Neni 3, pika 3.2 të specifikohet: Shpërblimi për sportistin më të suksesshëm Senior, Junior dhe Kadet.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe diskutimin publik me qytetarë.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi